**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0050850/26 dt. 26.08.2026**
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 2 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **hënën** më dt. **31.08.2026**:

**T H Ë R R E T**
**Mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa**
**(Mbledhja e 8-të)**

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026
3. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026
4. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026
5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026
6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026
7. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026
8. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026

**Mbledhja do të mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.**

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E MITROVICËS – OPŠTINA MITROVICE – REPUBLIKA KOSOVO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – RepublicofKosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
OpštinaJuzna Mitrovica – Municipalityof Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**Nr. 02-060/01-0041998-1/26 dt. 28.07.2026**
**Mitrovicë**

**P R O C E S V E R B A L**
**Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa**
**Mbledhja e 7-të**

**Koha**: 28.07.2026 ora 10:00
**Vendi**: Salla e Mediave
**Të pranishëm**: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami, Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla
Nënkryetari i komunës z. Enis Osmani,
Anëtarët e Bordit të Drejtorëve
**Mungoi**:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot kam thirrur mbledhjen e shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Po ashtu Kryesuesi theksoi se në rend dite propozohet të hyjë edhe Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026, i njëjti ka ardhur në Sekretarinë e Kuvendit para thirrjes së mbledhjes, por për shkak të një gabimi tim nuk është përfshirë në rend dite.

Në vazhdim Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Nazmi Kelmendi: Propozoj që në rend dite të hyjë Propozim-vendimi për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik, me numër të parcelës P-71202012-00009-l, Zona kadastrale në Kçiq.

Kryesuesi hedh në votim propozimin që si pikë e 18-të të hyjë Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026.

**Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.**

Kryesuesi konstatoj se unanimisht u miratua propozimi që si pikë 18-të të hyjë Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026.

Kryesuesi hedh në votim propozimin që si pikë e 19-të të hyjë Propozim-vendimi për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik.

**Rezultati i votimit: 4-për, 1-kundër, 0-abstenime.**

Kryesuesi konstatoj se me shumicë votash u miratua propozimi që si pikë e 19-të të hyjë Propozim-vendimi për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik.

Në vazhdim Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të plotësuar si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike
3. Propozim-vendim për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë
4. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra
5. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "REC" – Mitrovicë
6. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "OPFAKOS" – Mitrovicë
7. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "SË BASHKU" – Mitrovicë
8. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "Zëri i Prindërve" – Mitrovicë
9. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "HANDIKOS" – Mitrovicë
10. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën "Minatori '89"
11. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë
12. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë
13. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri
14. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut
15. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Raba Voca" në Mitrovicë
16. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-s "Down Syndrome Kosova" – Dega në Mitrovicë
17. Raport gjashtëmujor i punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane (janar-qershor 2026)
18. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026
19. Propozim-vendimi për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik

**Rendi i ditës u miratua unanimisht (6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime)**.

**Pika 1**

Igballe Islami: Në procesverbalin e mbledhjes së kaluar te pika 10, diskutimi im është përfshirë në procesverbal, po ashtu edhe shqetësimi që kam ngritur lidhur me një informacion të publikuar në opinion

se mjetet e destinuara për shkollat janë shpenzuar për nevoja të tjera, konkretisht për furnizim me lule në kuadër të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, mirëpo në procesverbal mungon përgjigja e Nënkryetarit të Komunës z. Enis Osmani si dhe diskutimi i Drejtorit të Financave.

Kryesuesi i mbledhjes z. Safet Kamberi: Unë besoj se në procesverbal janë shënuar të gjitha diskutimet që janë zhvilluar sipas protokollit të udhëheqjes së mbledhjes. Të gjitha diskutimet që i keni bërë jashtë temës, apo jashtë fjalës që ju është dhënë, si dhe rastet kur keni folur njëkohësisht duke ia ndërprerë ose mbivendosur fjalën njëri-tjetrit, normalisht nuk përfshihen në procesverbal. Për të gjitha diskutimet për të cilat unë jua kam dhënë fjalën, procesmbajtësi e ka obligim t'i shënojë. Ndërsa ato që janë zhvilluar jashtë rendit të diskutimit ose pa të drejtën e fjalës, mos prisni që të përfshihen në procesverbal. Unë besoj se kjo është arsyeja. Gjithsesi, kjo mund të verifikohet lehtësisht.

Igballe Islami: Pyetja ime është e shënuar deri në fund, ndërsa më pas thuhet se nuk ka pasur të tjerë të paraqitur për diskutim. Për diskutim nuk ka pasur, por unë kam marrë dy përgjigje, një nga nënkryetari dhe një nga drejtori. Prandaj, ose duhet të shënohen edhe përgjigjet, ose të hiqet edhe pyetja, sepse unë nuk kam diskutuar me veten.

Kryesuesi vuri në votim Procesverbalin nga mbledhja e gjashtë e KPF-së, me kërkesën që Sekretaria të verifikojë vërejtjen e znj. Igballe Islami.

**Procesverbali nga mbledhja e gjashtë e KPF-së u miratua unanimisht (6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime)**.

**Pika 2**

Kryesuesi z. Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Draft-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike, theksoi se janë respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore për hartimin e kësaj draft-rregulloreje.

Drejtori i DPU-së z. Ardian Kavaja në pika të shkurtra e arsyetoi Draft-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Kushtrim Zeneli: Unë do të ndalem vetëm te neni 6, pika 1.6, e kësaj Rregulloreje të re: "Pëlqimi i banorëve (2/3 e banorëve të njësive të ndërtesës) të cilët gjenden në atë anë të fasadës ku vendoset reklama, si dhe pëlqimi i poseduesit të pronës nëse aplikuesi nuk është pronar". A është shqyrtuar kjo pikë në aspektin juridik dhe sa është e zbatueshme.

Ardian Kavaja: Ne e kemi pasur këtë si shqetësim edhe gjatë takimeve me Komisionin. Meqenëse Rregullorja ende vazhdon të jetë në shqyrtim deri në ditën e Kuvendit, ne kemi mundësi ta ndryshojmë. Kështu na është njoftuar edhe nga Sekretaria. Prandaj, në këtë pikë besoj se do të ishte më e udhës që të kërkohet vetëm certifikata e biznesit për operatorin, si dhe certifikata përkatëse, sepse kjo mund të na nxjerrë vështirësi në zbatimin praktik. Ky ka qenë një rekomandim i Komisionit, por përfundimisht vendimi është që këtë çështje mund ta diskutojmë edhe më tej. Me gjasë, kjo pikë do të largohet.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Draft-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

**Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.**

**Draft-Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika 3**

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë.

**Rezultati i votimit: 5 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika 4**

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra.

**Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes propozoi që pikat 5 deri 16 të diskutohen bashkërisht për shkak të tematikës së njëjtë, ndërsa votimi do të bëhet veç e veç.

**Pikat: 5 deri 16**

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me pikat 5 deri 16.

Igballe Islami: Realisht, vetëm një pyetje do ta kisha për drejtorin, meqenëse natyra e këtyre OJQ-ve në këtë rast është e njëjtë, pse nuk është bërë subvencionimi i tyre përmes thirrjes publike, për t'u mundësuar që të përfitojnë shuma më të mëdha, unë e di që disa vite ka pasur një praktikë të tillë, ndërsa më pas nuk ka pasur thirrje. Kjo, me sa e di, ka qenë në përputhje me planin e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Mirëpo, a e vlerësoni se Strehimorja "Raba Voca" duhet të subvencionohet me 500 €, duke i pasur parasysh shpenzimet që i ka, dhe pikërisht për këtë të krahasohet me një OJQ tjetër? Pra, saktësisht pyetja ime është: pse nuk po shkohet me një thirrje publike për të gjitha këto OJQ, në mënyrë që t'u mundësohet të aplikojnë dhe të përfitojnë sipas Rregullores? Sepse, sipas vlerësimit tim, kjo shumë prej 500 € nuk është shumë adekuate, pikërisht duke i pasur parasysh shpenzimet dhe kushtet me të cilat përballen këto organizata.

Erseka Barani: E kisha edhe unë shqetësimin sikurse Igballi. Do të thotë, edhe vitin e kaluar kemi vepruar në të njëjtën formë. Sa i përket shoqatave të dala nga lufta, i kemi pasur të përkrahura me nga 500 € dhe kjo ka qenë kërkesë e imja që, të paktën, të shkohet përmes një thirrjeje publike. Nga ajo që kam mundur të shoh, drejtor, në buxhetin e aprovuar, te subvencionet për shërbimet sociale, për këtë vit, për vitin 2026, janë 224,825 €. Kështu që mendoj se këtë proces mund ta bëni shumë më mirë. Unë, para disa ditësh, pata një takim edhe me HANDIKOS-in në Mitrovicë, dhe kërkesat e tyre, krahasuar me disa organizata të tjera, dallojnë shumë. Kështu që mendoj se nuk duhet të na vendosni në një situatë ku ne, në njëfarë forme, t'i subvencionojmë të gjitha organizatat me nga 500 €, duke e ditur se secila prej tyre ka kërkesa dhe nevoja të ndryshme. Do të ishte shumë më mirë që të shkohet përmes thirrjeve publike, në mënyrë që t'i përkrahim këto organizata konform nevojave dhe projekteve të tyre. Kësaj radhe jam për përkrahjen e tyre dhe mendoj se Strehimorja „Raba Voca" dhe Organizata për Përkrahjen e Viktimave të Dhunës në Familje, me nga 250 €, duhet të tërhiqen nga kjo mënyrë e subvencionimit, domethënë të mos përfshihen në këtë grup. Mirëpo, sa i përket organizatave të tjera, si HANDIKOS, REC dhe OPFAKOS, mendoj se të gjitha kanë nevoja të ndryshme. Prandaj, mendoj se përkrahja duhet të bëhet përmes thirrjeve publike, duke u bazuar në nevojat dhe projektet që ato i kanë. Natyrisht, duhet të mbahen edhe përgjegjëse përmes raportimit, pasi të jenë subvencionuar. Do të kishte qenë shumë më mirë që, përmes thirrjes publike, meqenëse ka mjete të planifikuara, të përkrahen këto organizata në mënyrë më të drejtë dhe më transparente. Për më tepër, këtë vit janë ndarë edhe 50 mijë € për shërbimin

e varrimit. Prandaj, mendoj se ka mjete të mjaftueshme për të hapur një thirrje publike për këto organizata.

Igballe Islami: Kërkoj falje, sepse unë mendova që vetëm këtu hynë subvencionimi i OJQ-ve, e jo edhe te pjesa e banorëve të Lagjes Bajr. Fillimisht, banorët e Lagjes Bajr janë subvencionuar një herë në vitin 2023 me 2,500 €, ndërsa më pas janë subvencionuar edhe me nga 10,000 €. Unë po dua, drejtor, t'i di kushtet, pikërisht çfarë dhe cilat janë procedurat sa i përket kësaj çështjeje. Ju na e keni aprovuar edhe një raport të dëmeve në Lagjen Bajr. A e keni adresuar atë te Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), në këtë rast, dhe a keni kërkuar subvencionimin e tyre nga niveli qendror? Sepse ne, askush këtu, nuk është kundër subvencionimit të qirave të tyre prej 250 € për tetë familje. Edhe pse unë e di dhe besoj se jam i informuar që mund të ketë edhe më shumë familje, mirëpo ndoshta të tjerat nuk kanë nevojë për subvencionim të qirasë. Nuk është se jemi kundër; jemi shumë pro shumicës së masave që po ndërmerrni për t'i ndihmuar. Mirëpo, kjo shumë është aq e vogël, aq simbolike, sepse këto familje nuk është se nuk kanë përfituar shuma të tilla edhe më parë, e aq më tepër që kjo shumë po del shumë më e vogël sesa ajo që kanë përfituar në të kaluarën. A është duke u shqyrtuar rasti i tyre në mënyrë procedurale dhe administrative, sa i përket subvencionimit dhe zgjidhjes së tyre të përhershme? Sepse problemi nuk zgjidhet nëse e aprovojmë këtë nevojë vetëm me 250 € në muaj. Dhe, saktësisht, a është dorëzuar raporti i AME-së edhe te institucionet e tjera që kanë përgjegjësi për mbulimin e këtyre rasteve emergjente?

Valon Brahimi: Sa i përket çështjes së subvencionimit, meqë nënkryetari është këtu, unë mendova se është drejtoresha e Shëndetësisë, është një kërkesë e cila është deponuar në Drejtorinë e Shëndetësisë për ndihmë financiare. Është një shumë që ndoshta nuk ka nevojë të kalojë në Kuvend, por që mund ta trajtoni edhe ju si ekzekutiv. Bëhet fjalë për Sulltane Gjinovcin, e cila, sipas dokumentacionit të dorëzuar në komunë, është 14-vjeçare dhe diagnoza e saj është epilepsia. Ajo ka kërkuar ndihmë financiare në shumën prej 940 € për nevoja të trajtimit. Mendoj se, nëse ua lejojnë mundësitë buxhetore, duhet ta keni parasysh edhe këtë kërkesë, aq më tepër që nuk bëhet fjalë për një shumë shumë të madhe. Përtej këtij aspekti institucional, është edhe një gjest i mirë human që mund ta bëjmë si Komunë dhe si Qeveri lokale, për t'i ndihmuar sa më shumë qytetarët tanë në raste të tilla.

Ramadan Beshiri: Fillimisht, sa i përket shpalljeve publike për OJQ-të, ato nuk kanë qenë të parapara. Nuk kanë qenë të parapara as vitin e kaluar, as këtë vit, sepse unë e kam trashëguar planin e punës së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe nuk më është lejuar mundësia që të bëj shpallje publike të tilla që në fillim. Prandaj, është dashur të gjendet një modalitet për t'i përkrahur OJQ-të në një formë të bazuar në Rregullore, duke respektuar kriteret dhe standardet, si dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, e cila lejon një limit prej maksimum 500 € për përkrahjen e OJQ-ve që operojnë në Komunën e Mitrovicës. Ne e kemi realizuar këtë mundësi që na e ka dhënë ligji, duke i përkrahur me nga 500 €. E dimë që nevojat janë shumë të mëdha, si te OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale, ashtu edhe te OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë e cenueshme, siç janë viktimat e dhunës, është OJQ "Raba Voca". Mirëpo, nuk na është lejuar mundësia që t'i përkrahim me shuma më të mëdha. Përndryshe, ne jemi duke e rishikuar mundësinë për t'i përkrahur edhe në mënyrë individuale. Siç e dini, viktimat e dhunës mund të përfitojnë në mënyrë individuale nga 250 €. Edhe OJQ "Raba Voca"-n, prapë do ta përkrahim për mbulimin e qirasë që e ka në objektin aktual. Së shpejti do të vendosen në objektin e ri dhe nuk do ta ketë më nevojën për mbulimin e qirasë. Ndërsa, sa i përket Lagjes Bajr, raporti u është dërguar AME-së dhe jemi në diskutime. Është e informuar edhe Qeveria qendrore dhe të gjithë janë duke e shqyrtuar modalitetin se si t'u dilet përfundimisht në ndihmë banorëve të Lagjes Bajr. Mirëpo, në situatën në të cilën gjenden momentalisht, ne e kemi paraparë që, brenda një viti, t'i përkrahim familjet e Lagjes Bajr me nga 250 € në muaj, që i bie 3,000 € për familje në vit. Përndryshe, familjet që kanë qenë në asistencë sociale, për të cilat kam pasur mundësi ligjore t'i përkrah, i kam përkrahur pa e sjellë çështjen në KPF dhe në Kuvend, sepse ma lejon Rregullorja. Ndërsa këtu, tetë familje do t'i përkrahim në këtë mbledhje të Kuvendit, ndërsa familjet e tjera në mbledhjen e ardhshme, e cila do të mbahet pas pushimeve, në shtator, për shkak të buxhetit. Sepse aty shifrat tregojnë se është një buxhet i madh, mirëpo shumica e parave, rreth 151 mijë €, janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve të varrimeve përmes Këshillit të Bashkësisë Islame, të cilat veçse do t'i realizojmë tashmë. Pra, ky buxhet është i paraparë, mirëpo po

presim që 50 mijë € të hyra vetanake, të cilat na kanë takuar nga viti i kaluar, t'i përdorim edhe për këtë qëllim.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "REC" – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 5 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "REC" – Mitrovicë u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "OPFAKOS" – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "OPFAKOS" – Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "SË BASHKU" – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "SË BASHKU" – Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "Zëri i Prindërve" – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 5 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "Zëri i Prindërve" – Mitrovicë u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "HANDIKOS" – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ "HANDIKOS" – Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën "Minatori '89".

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën "Minatori '89" u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Raba Voca" në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Raba Voca" në Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-s "Down Syndrome Kosova" – Dega në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Propozim-vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-s "Down Syndrome Kosova" – Dega në Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika 17**

Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Raportin gjashtëmujor të punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane (janar-qershor 2026).

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin gjashtëmujor të punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane (janar-qershor 2026).

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Raporti gjashtëmujor i punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane (janar-qershor 2026) u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

**Pika 18**

Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2026.

Kushtrim Zeneli: Meqë ne për këtë pikë kemi me diskutuar në Kuvend, po i kërkoj dy pika shtesë që ndoshta duhet të plotësohen në këtë raport. E para, nga Drejtoria e Financave kërkoj që të na sjellë

një informatë të shkurtër mbi inkasimin e borxheve të vjetra dhe mekanizmat që po përdoren për monitorimin e obligimeve financiare. Unë duhet ta kem këtë informatë nesër gjatë diskutimit të raportit financiar në Kuvend. Edhe pika tjetër: kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit që të përgatisë një informatë të shkurtër, lidhur me procesin e lëshimit të lejeve të ndërtimit, respektimin e procedurave dhe zbatimin e Rregullores, përfshirë edhe aplikimin e koeficienteve gjatë tri viteve të fundit. Nëse ka mundësi, këto dy informata t'i kemi nesër gjatë diskutimit të raportit financiar.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2026.

**Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026 u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

## Pika 19

Kryesuesi i mbledhjes para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratim paraprak të Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtorit të DGJKP-së z. Nazmi Kelmendi.

Nazmi Kelmendi: Për shkak të sqarimit, nëse mundem me thanë gabim teknik, unë e kam filluar procedurën për dhënien në shfrytëzim të katër parcelave. Mirëpo, për shkak të ngarkesës së punëve në drejtori dhe angazhimeve të tjera, nuk ka pasur mundësi që të përgatitet lënda për të gjitha parcelat. Përgjigjet nga Drejtoria e Urbanizmit, nga Avokati i Komunës dhe nga shefi i sektorit i kam për katër parcelat, mirëpo sot ka mundur të përfundohet vetëm propozimi për një rast në Kçiq, për të cilin e keni dokumentacionin para vetës.

Igballe Islami: Fillimisht drejtor, kur kemi të bëjmë me pronën komunale, edhe një herë në seancën e Kuvendit kemi diskutuar që me pronat komunale nuk bëhet politikë. Për pronat komunale do të mundohemi që secili t'i respektojë ligjet dhe rregulloret në fuqi. Fillimisht, unë po vlerësoj se nuk është proceduralisht në rregull dhe nuk është e drejtë nga ana juaj që një pikë aq e rëndësishme, siç është dhënia në shfrytëzim e pronës, jo vetëm përcaktimi se cilat prona do të jepen në shfrytëzim, që ka qenë si pikë herën e kaluar, por tash edhe dhënia në shfrytëzim, të na sillet sot dhe të kërkohet të futet në rend dite pa pasur asnjë dokumentacion para vetes. Unë nuk mundem ta pranoj një çështje të futet në rend dite vetëm nëse ma lexoni numrin e parcelës, një, dy, tre, katër..., sepse unë nuk e di se ku gjendet ajo parcelë. Domethënë, duhet ta kemi dokumentacionin para vetes, sepse kjo është një pikë shumë e ndjeshme. Fillimisht, ne shumë shpejt e morëm materialin dhe nuk patëm mundësi as ta shqyrtojmë e as ta analizojmë nëse duhet ta votojmë materialin që na e sollët këtu përpara. Tash unë votova, meqenëse e patëm bërë edhe me subvencionimin dhe vetëm u bazova te anëtarët e Komitetit. Mirëpo, po dua ta pyes drejtorin: A e ke bërë këtë në kuadër të Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë? A e konsideron veten kompetent për t'i dhënë pronat në shfrytëzim dhe për ta iniciuar këtë çështje? Meqenëse ju e keni aprovuar dhe ne e kemi aprovuar në Kuvendin Komunal Rregulloren për ndarjen e kompetencave në Komunën e Mitrovicës, Rregullorja Nr. 02/2024, nëse nuk gaboj. Më duket se është kështu dhe aty është përcaktuar Drejtoria për Pronë, në kuadër të së cilës janë sektori i pronës, sektori i shpronësimit dhe sektori i këmbimit. Domethënë, potencialisht, ti nuk je kompetent as për ta iniciuar këtë çështje. Është drejtori përkatës që do të duhej të emërohej dhe të vepronte sipas Rregullores, sepse nëse i referohemi Rregullores, ti nuk je kompetent për këtë çështje. Drejtoria e Kadastrit ka detyra dhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara në atë Rregullore. Pika e dytë, të cilën dua ta diskutoj shumë shkurt, është mënyra se si e ke sjellë këtë pikë. Kush ka bërë shprehje interesi? Kujt do t'i jepet kjo pronë? Domethënë, kush ka bërë kërkesë për t'iu dhënë kjo pronë në shfrytëzim? Ne duhet ta kemi të qartë këtë dhe ta kemi të gjithë dokumentacionin përkatës. Tash po thuhet se janë vonuar kërkesat dhe përgjigjet e drejtorive. Mirëpo, kur i ke bërë kërkesat dhe kur i ke kërkuar përgjigjet, kjo nuk është çështje që duhet të ndikojë në punën e Kuvendit Komunal. Nëse ti sot, me nguti, në një mënyrë të tillë mundohesh ta shtysh vetëm një pikë të rendit të ditës, domethënë vetëm njërën nga këto parcela, me të vërtetë është e çuditshme. Pse nuk pritët të kompletohen të katër parcelat dhe të vendosen në njërën prej seancave të radhës, kur do të thirret seanca, në mënyrë që të kemi kohën e nevojshme dhe kohën e duhur, si të gjithë anëtarët e Komitetit,

po ashtu edhe anëtarët e Asamblesë Komunale, për ta shqyrtuar materialin? Pika e parë: unë nuk e vlerësoj se ti je kompetent për ta iniciuar këtë çështje. Dhe pika e dytë, aq më e rëndësishme, është: Kush ka kërkuar që t'i jepet kjo pronë? Kush ka bërë kërkesë? Ne realisht duhet ta kemi komplet dokumentacionin dhe ta dimë se kush ka bërë shprehje interesi. Nuk mund të hamendësojmë se kujt do t'i jepet kjo pronë. Edhe koha që na është dhënë për ta shqyrtuar këtë çështje është shumë e pamjaftueshme. Unë nuk e di se si është mundur të sillet dhe të propozohet kjo pikë në këtë mënyrë. Por, kur kemi të bëjmë me pronë komunale, nuk ka politikë. Krejt natyrshëm mund të diskutojmë dhe të themi se duhet të veprohet në një mënyrë apo në një tjetër, mirëpo kur bëhet fjalë për pronë komunale, nuk duhet të ketë politikë. Edhe diskutimi për këtë çështje nuk duhet të jetë politik. Thjesht, po vlerësoj se ti duhet vetë të kërkosh ta tërheqësh këtë pikë, ta kompletoni dokumentacionin dhe t'i sillni të katër parcelat që i paske ndërmend t'i japësh në shfrytëzim, përmes së njëjtës mënyrë dhe të njëjtës procedurë. Pastaj, a është mënyra e duhur apo jo, për këtë mund të diskutojmë edhe në Kuvend. Mirëpo, vetëm deri këtu, unë po e konsideroj se nuk je kompetent për ta iniciuar këtë çështje.

Valon Brahimi: Kjo është ndoshta çështja më e ndjeshme dhe më problematike që ka ardhur në Kuvend prej se jemi në këtë mandat. Bëhet fjalë për një operator ekonomik. A ka ndryshuar operatori? Drejtor, vetëm një pyetje. A ka ndryshuar ai?

Nazmi Kelmendi: Po.

Valon Brahimi: Kush ka shprehur interes për këtë dhënie në shfrytëzim? Pse pikërisht kjo pikë është sjellë tani dhe pse ka pasur një ngutje të tillë? Po dua ta shtroj pyetjen më qartë: pse këtë pikë u mundove ta procedosh kaq shpejt? Të tjerat i ke sjellë me procedurë tjetër, ndërsa këtë po mundohesh ta sjellësh me nguti. Pse ka ndodhur kështu? Po dua të të them se kjo çështje është dyfish problematike. E para, propozimit tënd është dashur t'i paraprijë diskutimi me banorët. Kjo është shkelje procedurale. Unë jam për respektimin e procedurave dhe ligjit. Për çështje të tilla, nëse nuk zbatohen procedurat, mund të ketë edhe përgjegjësi institucionale dhe ligjore. Operatori në fjalë, nënkryetar, i ka shkatërruar rreth 2.5 kilometra rrugë, të cilat janë ndërtuar me paratë e taksapaguesve të Komunës, ndërsa gjendja e tyre tani është shumë më e keqe. Operatori që ka vepruar atje, për shkak të detonimeve, ka shkaktuar dëme dhe ka vepruar në kundërshtim me paramasat. Ka humbur rrjedha e kroit dhe janë shkaktuar dëme të mëdha në shtëpitë e banorëve. Dëmtohet rëndë interesi i qytetarëve nëse kësaj çështjeje nuk i paraprin një diskutim publik. Nëse është mbajtur diskutim publik, atëherë duhet ta dimë dhe ta kemi të dokumentuar. Edhe, siç e dini, nuk e di nëse e keni parasysh se janë mbledhur rreth 6-7 mijë nënshkrime nga qytetarët që kanë kundërshtuar këtë çështje dhe mënyrën e veprimit tuaj. Kjo çështje ka dalë edhe gjatë kohës kur kam qenë unë drejtor, për shkak se nuk ka pasur kontratë për shfrytëzimin e pronës komunale. Ndiqni procedurat! Mbajeni diskutimin publik, sepse nuk mund të sillni një çështje të tillë pa i pyetur më parë banorët. Ata do të vijnë këtu dhe do të kërkojnë llogari. Bashkë me ta do të jem edhe unë, sepse bëhet fjalë për njerëz që jetojnë aty dhe që kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre. Nuk mund ta vështirësojmë edhe më shumë jetën e tyre. Kjo është një çështje që duhet trajtuar me shumë kujdes. Kështu që, ndiqni procedurat, kini parasysh interesin e banorëve. Është interes edhe i yni që operatorët të punojnë, por kur vihet përballë interesi i dhjetë mijë banorëve me interesin e një biznesi, vallë nuk është në rregull të merren parasysh së pari interesat e qytetarëve? Ne e dimë çfarë po mendohet dhe e dimë se si po veprohet, prandaj po ju tërheqim vërejtjen për këtë çështje. Për këtë punë jam i gatshëm të shkoj deri në fund. Jam përfaqësues i atij lokaliteti dhe, nëse nuk e mbroj interesin e tyre, unë e jap dorëheqjen sot. Cilat janë kriteret që do t'i përdorni për t'ia dhënë në shfrytëzim një operatori këtë pronë? Kush do t'i evidentojë dhe do t'i verifikojë dëmet që janë shkaktuar deri më tani? Dëmet në shtëpi? Në natyrë? Në rrugë? Janë mbledhur mijëra nënshkrime. A duhet të merret parasysh qëndrimi i Komunës apo duhet t'u jepet përparësi banorëve? Mbajeni një diskutim publik për problemet e banorëve. Nëse banorët janë pro kësaj pune, atëherë, urdhëroni, procedojeni në Kuvend. Kjo është një nga çështjet më të ndjeshme me të cilën po përballemi prej dhjetë vitesh. Edhe në kohën kur kam qenë drejtor unë, edhe në kohën kur ka qeverisur Agimi, ka pasur telashe të tilla. Ka pasur raste kur banorët kanë ardhur dhe kanë protestuar para zyrave tona. Kështu kanë vepruar me mua, kështu kanë vepruar edhe më parë dhe, padrejtësisht, mund të veprojnë edhe ndaj jush. Unë e di që, ligjërisht, nëse zbatohen procedurat dhe mbahet diskutimi publik me banorët, duhet të respektohen edhe afatet dhe të gjitha procedurat përkatëse.

Prandaj, mund të vazhdohet me këtë pikë, por duhet të keni shumë kujdes, sepse mund t'i nxitni banorët të reagojnë dhe të protestojnë. Shkoni dhe merrni pëlqimin e banorëve, mbajeni diskutimin publik dhe bëjeni të ditur përmes njoftimeve përkatëse. Jo të shkoni me një grup prej njëzet personash dhe pastaj të thoni se e kemi mbajtur diskutimin publik. Duhet të respektohen procedurat e njoftimit, në mënyrë që të gjithë banorët të kenë mundësi të informohen dhe të shprehin mendimin e tyre. Përndryshe, kam shumë respekt për ju të dy dhe për të gjithë këtu, por për një çështje të tillë duhet të kemi shumë kujdes se si po procedohet. Unë nuk kam asgjë kundër asnjë biznesi, por për këtë çështje jam i gatshëm të vij edhe vetë të protestoj bashkë me ata banorë, sepse konsideroj se është dëm i madh për atë lokalitet. Shkoni, mbajeni diskutimin publik dhe merrni pëlqimin e banorëve. Unë jam i pari që do ta përkrah këtë çështje nëse banorët pajtohen. Përderisa nuk merret pëlqimi i banorëve dhe nuk respektohen procedurat, unë jam kundërshtari i parë dhe protestuesi i parë para Komisionit.

Igballe Islami: Drejtori duhet me na pritë vetë derisa ta shqyrtojmë materialin, dy-tri orë, që pyetjet tona me i adresu. Tash e sjelle materialin, e ne nuk po mundemi me i kontrollu. Kush e ka bërë kërkesën, kush ka shprehur interes, a është e regjistrume. A e keni regjistru dje. Kjo është për dhënie në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vjet. Mirëpo, sa i përket kësaj parcele, nr. 009-1 Kçiq i Madh, a është pjesë e listës që e keni aprovuar në Kuvend për dhënien në shfrytëzim të këtij viti. Pse nuk është edhe vendimi, pra, i bashkëngjitur, që na me pasë sigurinë që është e bashkëngjitur? Qysh me ditë ne? Domethënë, aq e pakompletuar është kjo lëndë, aq hipoteza ka brenda saj. Qysh me aprovu? Qysh me ditë Asambleja Komunale, në këtë rast ata që kanë me aprovu sot në këtë komitet, që kjo është pjesë e vendimit që e keni marrë për me e dhënë në shfrytëzim gjatë vitit 2026, kur s'është vendimi i bashkëngjitur? Edhe Avokati edhe Drejtoria përgjigjet i kanë sjellë para kohe, a është tendenca juaj që pikërisht në Komitetin për Politikë dhe Financa me e sjellë si pikë shtesë të rendit të ditës? Përgjigjet e tyre janë gjithmonë më herët se kërkesat e tua. Domethënë, është tendencioze nga ana jote. Krejt këto fjalë kanë me qenë në procesverbal. Është tendencioze. Është qëllimi i tij për me e sjellë sot në rend dite, se ka mujt me e sjellë më herët pikën. Qysh mendoni me arsyetu veten kur nuk e sillni pikën e rendit të ditës? Çka është më me rëndësi se me dhënë pronën komunale në shfrytëzim? Krejt punët tjera presin. Domethënë, është qëllim i yti paraprak.

Valon Brahimi: Kërkoj që të ceket në procesverbal që propozim-vendimit t'i bashkangjitet Vendimi i aprovuar nga Kuvendi me parcelat që janë paraparë me u dhënë në shfrytëzim gjatë këtij viti, njoftimi për diskutim publik edhe procesverbali i mbajtjes së diskutimit publik në Kçiq, si dhe me ju bashkëngjitë lëndës kush ka ba shprehje të interesit. Por, përtej kësaj, unë e kisha kërkuar që kjo pikë mos me ardhë fare në Kuvend. Kjo është një punë që do diskutim më të madh. Do konsulta me banorët, do me këqyrë a po cenohet interesi i tyre. Edhe pastaj me marrë një vendim. Unë po ju tregoj se sot, nesër, pasnesër..., jam kundër kësaj pune.

Nënkryetari Enis Osmani: Po ndërlidhem me shqetësimet e znj. Igballe dhe të z.Valonit. Na e kemi marrë një interpretim prej MAPL-së, deri në emërimin e drejtorit të ri të Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit, varësisht, është i njëjti drejtor dhe vazhdon i njëjti drejtor me kompetenca të plota. Pavarësisht që rregullorja ka hyrë në fuqi, është konfirmimi prej MAPL-së dhe nuk ka asnjë kundërshtim. Sa i përket çështjes që e ngrite, nuk je kompetent për me dhanë pronën në shfrytëzim. Deri në emërimin e drejtorit tjetër, vazhdon drejtori që është. Pra, gjithçka në rregull është, është konfirmimi prej MAPL-së. Sa i përket parcelës, unë i kuptoj shqetësimet tuaja, mirëpo na nuk mundemi me thanë që ka me marrë X-ja ose Y-ja, se ajo thirrje është publike. Kanë të drejtë me apliku edhe operatorët, ose kushdo që vjen me apliku. Masandej, Komisioni për Vlerësim vendos a ka me u dhanë në shfrytëzim apo jo. Kjo është, domethënë, thirrje publike. Vijnë dhe aplikojnë, kështu që nuk na takon neve në këtë fazë me paragjyku se kush ka me e marrë. Edhe tjetra është te dëgjimet publike. Me ligj nuk parashihen në këtë fazë. Në fazat e mëvonshme nuk e di saktësisht. Thirrja ka me qenë e hapur. Ndoshta asnjë ofertë nuk është. Ky është faza veç e propozimit. Themelohet Komisioni, masandej ofertat... Është thirrje e hapur. A vjen me apliku dikush apo nuk vjen, është çështje tjetër. Edhe ajo është fazë e mëvonshme. Kur të jepet licenca për dikë, ajo duhet me pasë dëgjimin publik, jo në këtë fazë. Për këtë arsye bëhet Komisioni. E keni me qenë prezent edhe dikush prej opozitës në këtë komision, masandej, në qoftë se nuk është diçka në

rregull, na edhe kena me marrë konfirmimin e ligjshmërisë prej MAPL-së, sa i përket kësaj pune, me e vërtetu edhe atë që e ngritët ju, edhe pjesën tjetër për dëgjim publik.

